



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË**

VENDIM

NR. 126, DATË 30/11/2017

**PËR NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE,
ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË E KORÇËS SI DHE
PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET
ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2018**

Mbështetur në gërmën “f”, të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në ligjin nr. 68/2017 “ Për Financat e vetqeverisjes vendore”, në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, ligjin 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, ligjin 8519 datë 30.07.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, i ndryshuar, ligjin 9385 datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, ligjin 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, ligjin 10279 datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Këshilli i Bashkisë me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

- I. Të miratojë nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Korçës si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2018 si vijon:

II. Të gjitha Vendimet e Këshillit Bashkiak që bien në kundërshtim me këtë akt, shfuqizohen.

1. TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël. Të ardhurat gjithsej nga veprimtaria e biznesit të vogël nënkuptojnë çdo lloj të ardhure, të realizuar gjatë periudhës tatimore dhe përfshijnë, pa u kufizuar vetëm në to: të ardhurat e realizuara nga furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat nga pjesëmarrjet, të ardhurat nga interesat, të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme.

Këstet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës tatimore vjetore përcaktohen me udhëzim të ministrit të Financave. Gjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore ose në Postën Shqiptare, këstet tremujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të biznesit të vogël, brenda datës 20 prill, për muajt: janar, shkurt e mars; brenda datës 20 korrik, për muajt: prill, maj e qershor; brenda datës 20 tetor, për muajt: korrik, gusht e shtator; dhe brenda datës 20 dhjetor, për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor.” Në rast se aktiviteti i biznesit hapet, mbyllet apo pezullohet gjatë vitit fiskal, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël është proporcional me kohën e zhvillimit të aktivitetit dhe llogaritet në bazë të vetëdeklarimit të tatimpaguesit. Për tatimpaguesit e regjistruar për herë të parë gjatë vitit, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin llogaritet në bazë të qarkullimit dhe të fitimit të tatueshëm, të parashikuar nga vetë tatimpaguesi, për periudhën nga data e regjistrimit deri në fund të vitit të parë kalendarik.

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, me qarkullim vjetor nga 5 deri në 8 milionë, është 5% dhe për subjektet me qarkullim vjetor nga 0 deri në 5 milionë lekë, është 0 lekë në vit.

Çdo tatimpagues, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është i detyruar që deri më 10 shkurt të vitit që pason periudhën tatimore të dorëzojë një deklaratë vjetore tatimore, ku të jepen hollësisht të ardhurat gjithsej, shpenzimet e zbritshme, fitimi i tatueshëm, tatimi për t'u paguar, si dhe çdo hollësi tjetër e përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës tatimore vjetore. Detyrimin për paraqitjen e deklaratës vjetore në afatin e mësipërm e kanë edhe të gjithë tatimpaguesit e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 5 (pesë) milionë lekë.

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. Administrata Tatimore Qëndrore transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkive, ku ka vendndodhjen biznesi i taksueshëm, brenda datës 10 të muajit pasardhës, kur janë arkëtuar tatimet. Administrata Tatimore Qëndrore, për shërbimin që kryen, merr një komision. Ky komision llogaritet në përqindje të shumës së tatimit që kanë arkëtuar dhe kanë transferuar në buxhetin e

njësive të qeverisjes vendore, i cili është në masën 1 për qind dhe derdhet në llogari të Administratës Tatimore Qëndrore.

2. TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME.

Në këtë zë përfshihen **Taksa mbi ndërtesën, Taksa mbi tokën bujqësore dhe Taksa mbi truallin.**

2.a) Taksa mbi ndërtesën

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e së drejtës së pronësisë.

Baza e kësaj takse është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Sipërfaqja në pronësi e taksapaguesit përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë këtë pronësi. Taksapaguesi që nuk disponon dokumentin e pronësisë, vetëdeklaracionin sipërfaqen e taksueshme, e cila brenda tre muajve pasardhës nga momenti i vetëdeklarimit duhet të verifikohet nga inspektori i zonës në bashkëpunim me inxhinierin e rajonit apo në njësi administrative. Taksa e ndërtesës llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit dhe paguhet për vitin kalendarik, duke filluar nga data e krijimit të saj. Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori minimale të bazës për taksën mbi ndërtesën për Njësinë Administrative Korçë janë si vijon :

Kategoritë minimale të ndërtesave	Lekë/m² në vit
I. Ndërtesa banimi	
- ndërtuar para 1993	10
- ndërtuar gjatë dhe pas 1993	12
II. Ndërtesa të tjera	
- Për tregti dhe shërbime	300

- Të tjera Ndërtesat në pronësi ose në përdorim të organizatave jofitimprurëse, fondacioneve. Objekte të amortizuara, të dëmtuara dhe jashtë funksionit, si dhe sipërfaqe objektesh të pashfrytëzuara ku nuk zhvillohet aktivitet.	60
Ndërtesa që përdoren për veprimtari prodhuese	150
III. Ndërtesa në pronësi apo në përdorim, në territore të miratuara si fshatra turistike.	400

Shënim I : Në të gjitha njësitë administrative të tjera, niveli tregues i taksës për çdo kategori minimale të ndërtesës është sa një e dyta e nivelit tregues përkatës të kategorisë minimale të ndërtesës në njësitë administrative të përcaktuara në tabelë

Shënim II : Tatimpaguesit që kanë në pronësi më shumë se një banesë, për shtëpinë ku kanë banimin e zakonshëm paguajnë taksën e ndërtesës, sipas **seksionit I** të tabelës, ndërsa për të gjitha shtëpitë e tjera, taksa e ndërtesës është sa dyfishi i taksës së ndërtesës, që zbatohet në zonën ku ndodhet kjo ndërtesë.

Shënim III : Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit, të destinuara për shitje, por që janë ende të pa shitura, taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambientit të ndërtesës. Ambiente të hipotekuara si:

- apartamente banimi do të nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “Ndërtesa banimi”.
- ndërtesë biznesi do të nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “Ndërtesa të tjera për tregëti dhe shërbime”.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesën është Drejtoria e të Ardhurave të Bashkisë Korçë.

Për sa i përket kategorisë “çdo familje” për Njësinë Administrative Korçë për vitin 2017 për familjet për të cilat nuk kemi informacion në lidhje me sipërfaqen e ndërtesës së banimit detyrimi vjetor do të jetë fiks në nivelin 1.200 (një mijë e dyqind) lekë dhe për familjet për të cilat disponojmë sipërfaqen e ndërtesës detyrimi do të jetë në bazë të sipërfaqes. Detyrimet do të shpërndahen për periudhën janar 2017 – dhjetor 2017 dhe do të paguhet së bashku me faturën mujore të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, pranë sporteleve të Ujësjellës Kanalizime Korçë. Në të gjitha njësitë administrative të tjera për familjet për të cilat nuk kemi informacion në lidhje me sipërfaqen e ndërtesës së banimit detyrimi vjetor do të jetë fiks në nivelin 600 (gjashtëqind) lekë dhe për familjet për të cilat disponojmë sipërfaqen e ndërtesës detyrimi do të jetë në bazë të sipërfaqes.

Detyrimi i kësaj takse vjetore do të paguhet brenda datës 31.12.2017.

Për sa i përket kategorisë II “Ndërtesa të tjera”, në rastet kur tatim paguesi nuk paraqitet për plotësim dokumentacioni për efekt të llogaritjes së taksës

- sipërfaqja e taksueshme për Biznesin e Vogël është 50 m².
- sipërfaqja e taksueshme për Biznesin e Madh është 100 m².

Afati i pagesës së kësaj takse për kategorinë II “Ndërtesa të tjera”

- për Biznesin e Vogël dhe për Biznesin e Madh detyrimi paguhet brenda datës 30 Qershor i vitit fiskal.

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i ndërtesës bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së ndërtesës, pranë bashkisë ku ndodhet ndërtesa. Pas vetëdeklarimit Drejtoria e të Ardhurave mund të bëjë verifikimin në lidhje me saktësinë e këtij deklarimi dhe në raste të konstatimit të deklarimit të ndryshëm me realitetin pagesa do përlllogaritet për të gjithë periudhën.

Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike. Përfshihen nga pagesa e gjobës për pagesë në vonesë të gjithë taksapaguesit familjarë.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesën për familjarët është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Korçë, agjenti tatimor UKKO, administratorët e lagjeve (për njësinë administrative Korçë), kurse për njësitë e tjera administrative, struktura e ngarkuar është njësi administrative.

2.b) Taksa mbi tokën bujqësore.

Taksa mbi tokën bujqësore është detyrim vjetor dhe paguhet brenda datës 30 qershor të vitit fiskal. Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës në hektarë, në pronësi të taksapaguesit. Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë atë. Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori janë si vijon:

Klasifikimi sipas kategorisë së tokës bujqësore	Vlera e taksës në lekë/hektar/vit
I	4 200
II	3 500
III	2 800
IV	2 300
V	1 900
VI	1 600
VII-X	1 400

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka. Pas vetëdeklarimit Drejtoria e të Ardhurave mund të bëjë verifikimin në lidhje me saktësinë e këtij deklarimi dhe në raste të konstatimit të deklarimit të ndryshëm me realitetin pagesa do përlllogaritet për të gjithë periudhën.

Përfshihen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufutrore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Korçë, administratorët e lagjeve (për njësinë

administrative Korçë), kurse për njësitë e tjera administrative, struktura e ngarkuar është njësia administrative.

2.c) Taksa mbi truallin.

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në hektar, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit, është detyrim vjetor dhe paguhet brenda datës 30 qershor të vitit fiskal. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli. Pas vetëdeklarimit Drejtoria e të Ardhurave mund të bëjë verifikimin në lidhje me saktësinë e këtij deklarimi dhe në raste të konstatimit të deklarimit të ndryshëm me realitetin pagesa do përlllogaritet për të gjithë periudhën. Për çdo kategori minimale të truallit, këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Taksa e mbledhur, në mbështetje të këtij ligji, paguhet në buxhetin e bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.

Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori minimale të bazës për taksën mbi truallin është si vijon:

Klasifikimi sipas bashkive	Vlera e taksës në lekë/m ² /vit për qëllime banimi nga individët	Vlera e taksës në lekë/m ² /vit për qëllime biznesi
Bashkia Korçë	0,42 lekë/m ²	18 lekë/m ²

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi truallin për biznesin është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Korçë.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi truallin për familjarët është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Korçë, agjenti tatimor UKKO, administratorët e lagjeve (për njësinë administrative Korçë), kurse për njësitë e tjera administrative, struktura e ngarkuar është njësia administrative.

3. TAKSA E FJETJES NË HOTEL.

Me "hotel" kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.

Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel, për person. Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel”.

Kategoritë minimale të taksës së fjetjes në hotel	Bashkia Korçë
Hotelet 4-5 yje	175 lekë për natë fjetje
Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	70 lekë për natë fjetje

Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë, bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.

Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Drejtoria e të Ardhurave të Bashkisë Korçë.

4. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA.

1. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

2. Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë do të jetë sipas përcaktimeve në “Rregulloren Vendore të Planifikimit të Territorit të Bashkisë Korçë” pjesë e Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) por jo më pak se 4 për qind (përfshirë këtu edhe zonat ku sipas kodit të zonimit nuk ka përcaktim si kontribut në koston e infrastrukturës) dhe jo më shumë se 6 për qind të çmimit të shitjes për metër katror.

Për pjesët e territorit të bashkisë të pa përfshira në PPV taksa e ndikimit në infrastrukturë do të jetë 4 për qind të çmimit të shitjes për metër katror.

Për banesat e ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave për strehimin e familjeve të pastreha, pavarësisht nga zona ku ndërtohet, taksa e ndikimit në infrastrukturë do të jetë 4 për qind të çmimit të shitjes për metër katror.

Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njësisë të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, që miratohet çdo vit.

3. Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit do të jetë 3 për qind e kësaj vlere.

4. Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.

5. Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Për ndërtimet në proces legalizimi, objekt i dytë, taksa e ndikimit në infrastrukturë do të llogaritet si ndërtimet e reja që trajtohen me leje ndërtimi (Pika 2 dhe 3).

6. Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit.

7. Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki.

8. Pagesa e taksave do të kryhet pas miratimit të vendimit dhe zbardhjes së tij por jo më vonë se 15 ditë.

Struktura e ngarkuar për përlogaritjen, vjeljen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Korçë.

5. TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror

të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitje s së tyre. Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij sipas tabelës që vijon :

Kategoritë e ndërtesave	Njësia Administrative Korçë	Njësitë e tjera Administrative
	Zona 2 (Lekë/m ²)	Zona 3 (Lekë/m ²)
I. Ndërtesa banimi	300	100
II. Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	700	300
III. Ndërtesa të tjera	500	200

Shënim I: Në të gjitha njësitë administrative të tjera zbatojnë nivelin e taksës për zonën 3

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, e cila në rolin e agjentit tatimor, përfiton 3 për qind të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhit për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

6. TAKSA VJETORE E MJETEVE TË PËRDORURA.

Drejtoria Rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR), të cilat janë agjent tatimor të mbledhjes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura bazuar në legjislacionin në fuqi, mbledhin këtë taksë dhe e derdhin, brenda datës 30 të çdo muaji, për llogari të organeve tatimore të administratës qendrore dhe njësive të qeverisjes vendore.

Drejtoria rajonale e shërbimeve të transportit rrugor i ndan të ardhurat nga taksa e mjeteve të përdorura sipas njësive të qeverisjes vendore, mbështetur në vendbanimin e taksapaguesit që zotëron mjetin e transportit.

Nga shuma e përgjithshme e të ardhurave mujore të arkëtuara nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura, drejtoria rajonale të DRSHTRR-së, pasi mbajnë komisionin prej 5 (pesë)% të totalit mujor të të ardhurave, derdhin me anë të faturës për arkëtim, 25 (njëzet e pesë)% të këtyre të ardhurave në llogarinë bankare të degës së thesarit të rrethit, ku është njësia e qeverisjes vendore, dhe 75 (shtatëdhjetë e pesë)% të të ardhurave, DPSHTRR-ja e derdh për llogari të drejtorisë rajonale, ku është regjistruar (drejtoria rajonale e tatimpaguesve të mëdhenj).

Rakordimi i pagesës së taksës ndërmjet strukturave të DRSHTRR-së me organet tatimore të administratës qendrore dhe vendore kryhet në bazë të regjistrimit ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura, formati i të cilit është i përcaktuar me udhëzim të Ministrisë të Financave.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

7. TAKSA E TABELËS.

Kjo taksë aplikohet për të gjitha subjektet fizike, juridike, private e shtetërore, vendas apo të huaj që kryejnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Bashkisë Korçë. Niveli i kësaj takse për Bashkinë Korçë është si më poshtë vijon :

Kategoritë	Niveli i taksës
<p>1) Tabelë për qëllime identifikimi:</p> <p>a) Tabelë për qëllime identifikimi, deri në 2 metra katror, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brënda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë.</p> <p>a.1) Tabelë për qëllime identifikimi mbi 2 metra katror, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë.</p> <p>b) Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti në formën e përmasat e tabelave të sinjalistikës për orientim</p>	<p>0 lekë/vit</p> <p>45 000 lekë/m²</p> <p>120 lekë/vit</p>
<p>2) Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme dhe e palëvizshme:</p> <p>Për bashkitë qëndër qarku</p> <p>- Tabelë e thjeshtë</p> <p>- Tabelë elektronike</p> <p>3) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.</p>	<p>22 500 lekë/m²/vit</p> <p>45 000 lekë/ m²/vit</p> <p>1 000 lekë/m²/ditë</p>

Detyrimi i kësaj takse është vjetor dhe pagesa bëhet paralelisht me pagesën e taksave dhe tarifave të tjera. Derdhja e të ardhurave për këtë taksë në favor të bashkisë, bëhet brenda datës 20 Prill të vitit fiskal. Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Struktura e ngarkuar për dhënie leje për të vendosur tabelë reklamuese është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Korçë bazuar në kërkesën e subjektit që do të vendosë tabelë reklamuese.

Struktura e ngarkuar për identifikim, matjen dhe përlllogaritjen e kësaj takse është Drejtoria e Kontrollit të Territorit.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e të Ardhurave të Bashkisë Korçë.

Struktura e ngarkuar për penalitetet për mos pajisje me lejë për vendosje table reklamuese është Drejtoria e Kontrollit të Territorit.

8. DHËNIE E LIÇENCAVE PËR TREGËTIMIN E NAFTËS BRUTO DHE NËN PRODUKTEVE TË SAJ

Bazuar në Ligjin Nr.8450, datë 24.2.1999 “PËR PËRPUNIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGËTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE” të ndryshuar me Ligjin Nr .9218, datë 08.04.2004 “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8450, DATË 24.2.1999 “PËR PËRPUNIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGËTIMIN E NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE”, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 129, datë 18.03.1999 “PËR PROÇEDURAT DHE KUSHTET PËR DHËNIEN E LEJEVE E TË AUTORIZIMEVE PËR TREGËTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT E TË NËNPRODUKTEVE TË TYRE” të ndryshuar me Vendimet e Këshillit të Ministrave Nr. 170, datë 25.04.2002 & Nr. 563, datë 27.08.2004 “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME PËR PROÇEDURAT DHE KUSHTET PËR DHËNIEN E LEJEVE E TË AUTORIZIMEVE PËR TREGËTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT E TË NËNPRODUKTEVE TË TYRE”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 për “PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE TË KUSHTEVE PËR DHËNIEN E LIÇENCAVE PËR TREGËTIMIN E NAFTËS BRUTO DHE NËN PRODUKTEVE TË SAJ” Bashkia Korçë jep liçencë për personat juridikë të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre për tregëtimin e karburanteve për automjete (stacionet e shitjes së karburanteve) dhe për shitjen e lëndëve djegëse (njësitë e shitjes së lëndëve djegëse) në territorin e Bashkisë Korçë. Autorizimet jepen nga Bashkia Korçë **për një periudhë deri në 5 (pesë) vjet** me të drejtë përsëritjeje dhe pagesa për dhënie autorizimi për dy kategoritë e mësipërme është si më poshtë vijon.

- Pagesë për dhënien dhe përsëritjen e liçencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjete dhe vajra lubrifikante.

1 000 000 lekë

- Pagesë për dhënien dhe përsëritjen e liçencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregëtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë

100 000 lekë

Shënim:

Për dublikatë për të njëjtin stacion dhe afat vlefshmërie apo rastet e ndryshimeve në liçencë që kanë të bëjnë me elementet e përdoruesit të stacionit paguhet 20% e vlerës së plotë.

Struktura e ngarkuar për dhënien e kësaj liçence dhe vjeljen e detyrimit është Drejtoria e Kontroll Territorit në Bashkisë Korçë.

Struktura e ngarkuar për penalitetet për mos pajisje dhe mos zbatim të saj (bazuar në rregulloret përkatëse) është Drejtoria e Kontroll Territorit në Bashkinë Korçë.

TARIFAT VENDORE

I.	LLOJI I TARIFËS	VLERA
1.	TARIFË PASTRIMI	
	<ul style="list-style-type: none"> ➤ çdo familje në njësinë administrative Korçë ➤ çdo familje në njësinë administrative Bulgarec ➤ çdo familje në njësinë administrative Drenovë ➤ çdo familje në njësinë administrative Mollaj ➤ çdo familje në njësinë administrative Voskop ➤ çdo familje në njësinë administrative Voskopojë ➤ çdo familje në njësinë administrative Vithkuq ➤ çdo familje në njësinë administrative Lekas 	<p>3 800 lekë në vit</p> <p>1 500 lekë në vit</p> <p>1 500 lekë në vit</p> <p>1 500 lekë në vit</p> <p>1 500 lekë në vit</p> <p>1 500 lekë në vit</p> <p>1 500 lekë në vit</p> <p>500 lekë në vit</p>
	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Për institucionet shtetërore, shoqatat jofitimprurëse, unionet e kursim kreditit e të tjera të ngjashme me to. 	<p>30.000 lekë në vit</p>
	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Për subjektet e ndërtimit seli administrative : <ul style="list-style-type: none"> • Biznes i madh ➤ Për subjektet e ndërtimit B.V & B.M : <ul style="list-style-type: none"> • njësi ndërtimi (për çdo kantier ndërtimi, rrugë, shkolla, kopshte, objekte banimi kolektive e tregëtare, zyra dhe të tjera të ngjashme me to) • njësi ndërtimi banesa individuale • rikonstruksione • rikonstruksione të banesave individuale. 	<p>60.000 lekë në vit</p> <p>100 000 lekë / kantier</p> <p>20 000 lekë / kantier</p> <p>50 000 lekë / kantier</p> <p>10 000 lekë / kantier</p>

KUR VEPRIMTARIA KLASIFIKOHET B.M		
<ul style="list-style-type: none"> ➤ për njësi tregëtimi, shërbimi e artizanati - për njësinë administrative Korçë dhe për subjektet e ndodhura në anë të rrugëve nacionale (deri 50 m largësi nga aksi i rrugës) - për njësitë administrative të tjera 		50 000 lekë në vit 30 000 lekë në vit
<ul style="list-style-type: none"> ➤ për çdo njësi prodhimi - për njësinë administrative Korçë dhe për subjektet e ndodhura në anë të rrugëve nacionale (deri 50 m largësi nga aksi i rrugës) - për njësitë administrative të tjera 		80 000 lekë në vit 45 000 lekë në vit
<ul style="list-style-type: none"> ➤ për çdo njësi hoteli, moteli, pikë turistike - për njësinë administrative Korçë dhe për subjektet e ndodhura në anë të rrugëve nacionale (deri 50 m largësi nga aksi i rrugës) - për njësitë administrative të tjera 		80 000 lekë në vit 45 000 lekë në vit
<ul style="list-style-type: none"> ➤ për çdo njësi supermarketi - për njësinë administrative Korçë dhe për subjektet e ndodhura në anë të rrugëve nacionale (deri 50 m largësi nga aksi i rrugës) - për njësitë administrative të tjera 		110 000 lekë në vit 50 000 lekë në vit
➤ për çdo njësi hidroçentrali, frigoriferë, ferma, pulari		110 000 lekë në vit
➤ për çdo njësi llotari sportive dhe lojra fati		50 000 lekë në vit
➤ për çdo njësi gurore, furat e gërqeres, etj		110 000 lekë në vit
KUR VEPRIMTARIA KLASIFIKOHET B.V		
<ul style="list-style-type: none"> ➤ për të gjithë subjektet e B.V me qarkullim vjetor nga 0 deri 2 milion lekë në vit - për njësinë administrative Korçë dhe për subjektet e ndodhura në anë të rrugëve nacionale (deri 50 m largësi nga aksi i rrugës) 		10 000 lekë në vit
<ul style="list-style-type: none"> ➤ për të gjithë subjektet e B.V me qarkullim vjetor nga 2 deri 3 milion lekë në vit - për njësinë administrative Korçë dhe për subjektet e ndodhura në anë të rrugëve nacionale (deri 50 m largësi nga aksi i rrugës) 		10 000 lekë në vit
➤ për të gjithë subjektet e B.V me qarkullim vjetor		

	<ul style="list-style-type: none"> nga 3 deri 4 milion lekë në vit - për njësinë administrative Korçë dhe për subjektet e ndodhura në anë të rrugëve nacionale (deri 50 m largësi nga aksi i rrugës) ➤ për të gjithë subjektet e B.V me qarkullim vjetor nga 4 deri 5 milion lekë në vit - për njësinë administrative Korçë dhe për subjektet e ndodhura në anë të rrugëve nacionale (deri 50 m largësi nga aksi i rrugës) ➤ për të gjithë subjektet e B.V me qarkullim vjetor nga 0 deri 5 milion lekë në vit - për njësinë administrative Bulgarec - për njësinë administrative Drenovë - për njësinë administrative Mollaj - për njësinë administrative Vithkuq - për njësinë administrative Voskop - për njësinë administrative Voskopojë - për njësinë administrative Lekas ➤ për të gjithë subjektet e B.V me qarkullim vjetor nga 5 deri 8 milion lekë në vit - për njësinë administrative Korçë dhe për subjektet e ndodhura në anë të rrugëve nacionale (deri 50 m largësi nga aksi i rrugës) - për njësinë administrative Bulgarec - për njësinë administrative Drenovë - për njësinë administrative Mollaj - për njësinë administrative Vithkuq - për njësinë administrative Voskop - për njësinë administrative Voskopojë - për njësinë administrative Lekas ➤ për tregëtarët ambulante 	<p>12 000 lekë në vit</p> <p>15 000 lekë në vit</p> <p>5 000 lekë në vit</p> <p>5 000 lekë në vit</p> <p>5 000 lekë në vit</p> <p>5 000 lekë në vit</p> <p>5 000 lekë në vit</p> <p>5 000 lekë në vit</p> <p>20 000 lekë në vit</p> <p>7 500 lekë në vit</p> <p>7 500 lekë në vit</p> <p>7 500 lekë në vit</p> <p>7 500 lekë në vit</p> <p>7 500 lekë në vit</p> <p>7 500 lekë në vit</p> <p>250 lekë në vit</p>
2.	TARIFË PARKIMI	
	<ul style="list-style-type: none"> ➤ autovetura taksi 6 deri në 9 vendë ➤ autovetura taksi deri në 5 vendë ➤ autobusë ➤ automjet transport malli deri 3,5 T (me ngarkesë) ➤ automjet transport malli mbi 3,5 T (me ngarkesë) ➤ në vendparkime të rezervuara në qytet (përjashtimisht rastit të mëposhtëm) 	<p>8 000 lekë / vit</p> <p>4 000 lekë / vit</p> <p>50 lekë /orë</p> <p>2 000 lekë / vit *</p> <p>1 500 lekë / vit *</p> <p>10 lekë / orë</p>

	<ul style="list-style-type: none"> ➤ në vendparkime të rezervuara në zonat e parkimit me pagesë në rrugë ➤ në vendparkime publike me pagesë në rrugë <p>Shënim :</p> <p>* Tarifa e parkimit për automjet e transportit të mallit gjatë certifikimit të tyre do të paguhet sipas kërkesës së subjektit 1-5 vjet, kjo sipas udhëzimit nr.15 datë 24.07.2007 “PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E LËSHIMIT TË LICENCAVE, AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR” i ndryshuar të MPPTT – së.</p>	<p>20 lekë / orë</p> <p>50 lekë / orë</p>
3.	<p>TARIFË PËR THERJEN E BAGËTIVE</p> <p>a) Tarifë për therje në thertoret e Bashkisë</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Gjedhë ➤ Të imta ➤ Derra <p>b) Tarifë për certifikimin në thertoret private</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Gjedhë ➤ Të imta ➤ Derra <p>c) Tarifë për certifikimin e mallrave për import – export</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ certifikatë vërtetim për export ➤ certifikatë vërtetim për import ➤ certifikatë vërtetim për kafshë luksi ➤ kafshë dhe shpendë gjahu <p>d) Tarifë për certifikatë për mallra që qarkullojnë brenda vendit (Produkte ushqimore me origjinë shtazore)</p>	<p>500 lekë</p> <p>200 lekë</p> <p>300 lekë</p> <p>200 lekë</p> <p>50 lekë</p> <p>50 lekë</p> <p>3 000 lekë</p> <p>5 000 lekë</p> <p>1 000 lekë</p> <p>1 000 lekë</p> <p>1 000 lekë</p>
4.	<p>TARIFË PËR M² MUR TË JASHTËM PËR ÇDO NDËRTESE TË RE</p>	<p>20 lekë</p>
5.	<p>TARIFË PËR SERVITUTIN E KALIMIT NË PRONAT PUBLIKE</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ për njësinë administrative Korçë ➤ për njësitë administrative të tjera 	<p>110 lekë/m² në muaj</p> <p>55 lekë/m² në muaj</p>
6.	<p>TARIFË GJELBËRIMI</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ çdo familje në Njësinë Administrative Korçë ➤ për Njësitë Administrative të tjera 	<p>500 lekë në vit</p> <p>0 lekë në vit</p>

	<p>➤ Për institucionet shtetërore, shoqatat jofitimprurëse, unionet e kursim kreditit e të tjera të ngjashme me to</p> <p>➤ Për subjektet e ndërtimit seli administrative :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Biznes i madh <p>➤ Për subjektet e ndërtimit B.V & B.M :</p> <ul style="list-style-type: none"> • njësi ndërtimi (për çdo kantier ndërtimi, rrugë, shkolla, kopshte, objekte banimi kolektive e tregëtare, zyra dhe të tjera të ngjashme me to) • njësi ndërtimi banesa individuale • rikonstruksione • rikonstruksion banesa individuale <p>KUR VEPRIMTARIA KLASIFIKOHET B.M</p> <p>➤ për njësi tregëtimi, shërbimi e artizanati</p> <ul style="list-style-type: none"> - për njësinë administrative Korçë dhe për subjektet e ndodhura në anë të rrugëve nacionale (deri 50 m largësi nga aksi i rrugës) - për njësitë administrative të tjera <p>➤ për çdo njësi prodhimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - për njësinë administrative Korçë dhe për subjektet e ndodhura në anë të rrugëve nacionale (deri 50 m largësi nga aksi i rrugës) - për njësitë administrative të tjera <p>➤ për çdo njësi hoteli, moteli, pikë turistike</p> <ul style="list-style-type: none"> - për njësinë administrative Korçë dhe për subjektet e ndodhura në anë të rrugëve nacionale (deri 50 m largësi nga aksi i rrugës) - për njësitë administrative të tjera <p>➤ për çdo njësi supermarketi</p> <ul style="list-style-type: none"> - për njësinë administrative Korçë dhe për subjektet e ndodhura në anë të rrugëve nacionale (deri 50 m largësi nga aksi i rrugës) - për njësitë administrative të tjera <p>➤ për çdo njësi hidroçentrali, frigoriferë, ferma, pulari</p> <p>➤ për çdo njësi llotari sportive dhe lojra fati</p>	<p>5.000 lekë në vit</p> <p>5 000 lekë në vit</p> <p>10 000 lekë / kantier 2 000 lekë / kantier 5 000 lekë / kantier 1 000 lekë / kantier</p> <p>5 000 lekë në vit 2 500 lekë në vit</p> <p>6 000 lekë në vit 3 000 lekë në vit</p> <p>10 000 lekë në vit 5 000 lekë në vit</p> <p>10 000 lekë në vit 5 000 lekë në vit</p> <p>10 000 lekë në vit</p> <p>5 000 lekë në vit</p>
--	---	--

	<ul style="list-style-type: none"> ➤ për çdo njësi gurore, furat e gerqeres, etj <p>KUR VEPRIMTARIA KLASIFIKOHET B.V</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ për të gjithë subjektet e B.V me qarkullim vjetor nga 0 deri 2 milion lekë në vit <ul style="list-style-type: none"> - për njësinë administrative Korçë - për njësitë administrative të tjera ➤ për të gjithë subjektet e B.V me qarkullim vjetor nga 2 deri 3 milion lekë në vit <ul style="list-style-type: none"> - për njësinë administrative Korçë - për njësitë administrative të tjera ➤ për të gjithë subjektet e B.V me qarkullim vjetor nga 3 deri 4 milion lekë në vit <ul style="list-style-type: none"> - për njësinë administrative Korçë - për njësitë administrative të tjera ➤ për të gjithë subjektet e B.V me qarkullim vjetor nga 4 deri 5 milion lekë në vit <ul style="list-style-type: none"> - për njësinë administrative Korçë - për njësitë administrative të tjera ➤ për të gjithë subjektet e B.V me qarkullim vjetor nga 5 deri 8 milion lekë në vit <ul style="list-style-type: none"> - për njësinë administrative Korçë - për njësitë administrative të tjera ➤ për tregëtarët ambulantë <ul style="list-style-type: none"> - për njësinë administrative Korçë - për njësitë administrative të tjera 	<p>10 000 lekë në vit</p> <p>4 000 lekë në vit 0 lekë në vit</p> <p>4 000 lekë në vit 0 lekë në vit</p> <p>4 500 lekë në vit 0 lekë në vit</p> <p>5 000 lekë në vit 0 lekë në vit</p> <p>5 000 lekë në vit 0 lekë në vit</p> <p>100 lekë në vit 0 lekë në vit</p>
7.	<p>TARIFË PËR ZËNIE HAPËSIRË PUBLIKE</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Për tregëtim në tregje publike të miratuara nga bashkia të artikujve ushqimore, fruta – perime, vezë, mish, peshk, bulmet, kafshë të imta dhe të trasha e.t.j ➤ Për tregëtim tek inkubatori i biznesit (ish UMB) të artikujve industriale ➤ Për organizim panairë, tregëtim në hapësira publike. ➤ Për zënien e hapësirave publike për shërbim me tavolina jashtë lokalit, vendosje platformash, rrethim me kangjella, rrethim me vazo lule, e.t.j, për muajt 	<p>30 lekë/m²/ditë</p> <p>15 lekë/m²/ditë</p> <p>30 lekë/m²/ditë</p>

	<p>(Maj, Qershor, Korrik, Gusht, Shtator,)</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Për zënien e hapësirave publike për shërbim me tavolina jashtë lokalit, vendosje platformash, rrethim me kangjella, rrethim me vazo lule, etj. (për pjesën tjetër të vitit) ➤ Për zënien e hapësirave publike për tregëtim të artikujve industriale të artikujve ushqimore, fruta – perime, kantina, kënde lojrash etj. ➤ Për zënien e hapësirave publike për organizim të promociioneve dhe eventeve të tjera 	<p>19 lekë/m2/ditë</p> <p>10 lekë/m2/ditë</p> <p>50 lekë/m2/ditë</p> <p>1 000 lekë/m2/ditë</p>
8.	<p>TARIFË PËR MIREMBAJTJEN E VOREZAVE PUBLIKE</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ çdo familje në njësinë administrative Korçë ➤ çdo familje në njësinë administrative Bulgarec ➤ çdo familje në njësinë administrative Drenovë ➤ çdo familje në njësinë administrative Mollaj ➤ çdo familje në njësinë administrative Vithkuq ➤ çdo familje në njësinë administrative Voskop ➤ çdo familje në njësinë administrative Voskopojë ➤ çdo familje në njësinë administrative Lekas 	<p>500 lekë në vit</p> <p>500 lekë në vit</p> <p>500 lekë në vit</p> <p>500 lekë në vit</p> <p>500 lekë në vit</p> <p>500 lekë në vit</p> <p>500 lekë në vit</p> <p>0 lekë në vit</p>
9.	<p>TARIFË NDRIÇIMI</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ çdo familje në njësinë administrative Korçë ➤ çdo familje në njësinë administrative Bulgarec ➤ çdo familje në njësinë administrative Drenovë ➤ çdo familje në njësinë administrative Mollaj ➤ çdo familje në njësinë administrative Vithkuq ➤ çdo familje në njësinë administrative Voskop ➤ çdo familje në njësinë administrative Voskopojë ➤ çdo familje në njësinë administrative Lekas <p>➤ Për institucionet shtetërore, shoqatat jofitimprurëse, unionet e kursim kreditit e të tjera të ngjashme me to</p> <p>➤ Për subjektet e ndërtimit seli administrative :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Biznes i madh <p>➤ Për subjektet e ndërtimit B.V & B.M :</p> <ul style="list-style-type: none"> • njësi ndërtimi (për çdo kantier ndërtimi, rrugë, shkolla, kopshte, objekte banimi kolektive e tregëtare, zyra dhe të tjera të ngjashme me to) • njësi ndërtimi banesa individuale • rikonstruksione • rikonstruksione të banesave individuale 	<p>700 lekë në vit</p> <p>500 lekë në vit</p> <p>500 lekë në vit</p> <p>500 lekë në vit</p> <p>500 lekë në vit</p> <p>500 lekë në vit</p> <p>500 lekë në vit</p> <p>500 lekë në vit</p> <p>250 lekë në vit</p> <p>5 000 lekë në vit</p> <p>10 000 lekë në vit</p> <p>6 000 lekë / kantier</p> <p>2 000 lekë / kantier</p> <p>5 000 lekë / kantier</p> <p>1 000 lekë / kantier</p>

KUR VEPRIMTARIA KLASIFIKOHET B.M	
<ul style="list-style-type: none"> ➤ për njësi tregëtimi, shërbimi e artizanati - për njësinë administrative Korçë dhe për subjektet e ndodhura në anë të rrugëve nacionale (deri 50 m largësi nga aksi i rrugës) - për njësitë administrative të tjera 	<p>9 000 lekë në vit 4 500 lekë në vit</p>
